

**Zhvillohet në Tiranë takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve pjesëmarrëse të SEECP-së.  
Tiranë 24 Shkurt 2015**



Në kuadër të Kryesisë Shqiptare të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP), Ministri Bushati kryesoi takimin informal të Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve pjesëmarrëse në këtë nismë.

Në takim morën pjesë përfaqësuesit e 13 vendeve pjesëmarrëse në SEECP si dhe përfaqësues të Bashkimit Evropian, Presidencës letoneze të BE-së, Komisionit Evropian, Austrisë dhe Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC), këta të fundit të ftuar të posaçëm të Kryesisë shqiptare.

Takimi u përshëndet nga z. Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, i cili vuri theksin mbi rolin konstruktiv të Kryesisë shqiptare në këtë nismë. Ai nënvizoi rëndësinë e këtij takimi në proceset integruese të rajonit në strukturat evropiane dhe euro-atlantike si dhe përcolli mesazhe bashkëpunimi për rajonin.

Ministrat diskutuan mbi zhvillimet e fundit, situatën politike, nivelin e bashkëpunimit rajonal e të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, si element me rëndësi thelbësore për zhvillimin e Evropës Juglindore.

Me iniciativën e Kryesisë shqiptare, gjatë këtij takimi u miratua Deklarata e përbashkët kundër terrorizmit, duke dhënë kështu mesazhin e unitetit dhe seriozitetit në përballimin e sfidave të përbashkëta përmes veprimeve të përbashkëta.

Ministri Bushati ripërsëriti prioritetet e Kryesisë sonë për forcimin e rolit rajonal të SEECP-së, promovimin dhe nxitjen e dialogut midis vendeve anëtare dhe konsolidimin e rëndësisë sektoriale të kësaj nisme me qëllim orientimin e saj ndaj rezultateve të prekshme për publikun. Ai prezantoi aktivitetet e zhvilluara deri tani nën Kryesinë shqiptare dhe informoi homologët e tij mbi aktivitetet e parashikuara gjatë gjysmës së



parë të këtij viti. Ministrat dhanë mesazhe të forta për mbështetje të procesit të integritit në strukturat Evropiane dhe ato Euro-atlantike.

Ata theksuan se integrimi në BE ka pasur ndikim pozitiv në konsolidimin dhe ruajtjen e paqes dhe

stabilitetit në rajon si dhe në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të tij. Procesi i integritit, bazuar në meritë nuk duhet të ndalet, pavarësisht “lodhjes nga zgjerimi” dhe vendet e Evropës juglindore duhet të inkurajohen në këtë drejtim.

Ministri Bushati evidentoi se Kryesia shqiptare e forumit më të rëndësishëm politik në rajon përbën një sfidë dhe angazhim të rëndësishëm politiko-diplomatik për Shqipërinë, në funksion të promovimit e konfirmimit të mëtejshëm të rolit e të politikës së vendit tonë në rajon e më gjerë. Gjatë kryesisë sonë, në Tiranë do të vazhdojnë të zhvillohen një sërë aktivitete në nivel ekspertësh në bashkëpunim edhe me shoqërinë civile dhe botën akademike. Gjithashtu, janë parashikuar tre ministeriale në fushat e energjisë, bujqësisë e turizmit, në përputhje me prioritetet e kryesisë sonë.